VENDIM
Nr. 474, datë 31.7.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I VARREZAVE TË REJA", BASHKIA SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i varrezave të reja", Bashkia Shkodër.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Shkodër.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "tokë arë", me sipërfaqe 38 957 (tridhjetë e tetë mijë e nëntë-qind e pesëdhjetë e shtatë) m^2, me vlerë të përgjith-shme prej 9 868 500 (nëntë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 868 500 (nëntë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Shkodër, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Shkodër.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Shkodër.

8. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Shkodër, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të bashkisë.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN
PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "NDËRTIM I VARREZAVE TË REJA"
BASHKIA SHKODËR

Nr.	Emri, mbiemri (pronari që shpronësohet)	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Vol.	Faqe	Sipërfaqe totale m²	Lloji i pasurisë	Çmimi, lekë/m²	Vlera, lekë	Shënime
1	Kel Gjergj Çekaj Kastriot Kel Çekaj	1965	256/1	2	171	7000	arë	270	1,890,000	Konfirmuar nga ZRPP-ja shkresa nr. 3210/1, datë 13.5.2017
2	Lodovik Kol Çekaj	1965	256/4	2	174	5000	arë	270	1,350,000	Konfirmuar nga ZRPP-ja shkresa nr. 3210/1, datë 13.5.2017
3	Anton Kol Çekaj	1965	256/5 bëhet 256/40	5	82	4500	arë	270	1,215,000	Konfirmuar nga ZRPP-ja shkresa nr. 3210/1, datë 13.5.2017
4	Gjon Zef Shkambi	1965	256/8	2	178	7800	arë	270	2,106,000	Konfirmuar nga ZRPP-ja shkresa nr. 3210/1, datë 13.5.2017
5	Gjergj Ded Çuni	1965	256/13	2	183	5500	arë	270	1,485,000	Konfirmuar nga ZRPP-ja shkresa nr. 3210/1, datë 13.5.2017
6	Zef Gjelosh Kaceli	1965	256/44	2	181	2875	arë	270	776,250	Konfirmuar nga ZRPP-ja shkresa nr. 5954/1, datë 10.8.2017
7	Zef Gjelosh Kaceli	1965	256/45	2	181	2875	arë	270	776,250	Konfirmuar nga ZRPP-ja shkresa nr. 5954/1, datë 10.8.2017
8	Zef Gjelosh Kaceli	1965	256/13	2	181	1000	arë	270	270,000	Konfirmuar nga ZRPP-ja shkresa nr. 5954/1, datë 10.8.2017
	SHUMA								**9 868 500**	